



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijeno / Predato Received / Delivered	03-02-2023	viti god year	3
Organ / Mjesta Org / Mjesto Org / Unit	Nr Prot (u Prot Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKYSH/OK/4374/2023			1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1127/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti, dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.1127/2022 të datës 09.12.2022 të parashtruar nga ankuesi

në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 02.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1127/2022 e datës 09.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 40491 i datës 09.11.2022 i Komisionit të Pranimit në Shërbimin Civil të Komunës së Deçanit dhe Njoftimi i datës 07.11.2022 i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Deçanit lidhur shpalljen e kandidatit të suksesshëm.

A r s y e t i m

Komuna e Deçanit duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 24.08.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 16.09.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit *Specialistë i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës* me numër të referencës RN00009825 lidhur me pozitën "Teknik i Pylltarisë për Mbrotjtje dhe Monitorim" në Sektorin për pylltari për klasën e pozitës Profesional 4.

Ankuesi me datën 19.09.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur, në të cilën procedurë ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar

në renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 07.11.2022 të Komisionit të vlerësimit të Komunës së Deçanit, i njëjti është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 72 pikë, duke u renditur i treti (3) në listën mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve.

I pa kënaqur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatit fitues, me datën 07.11.2022, ankuesi ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Deçanit, me pretendimet ankimore se edhe pse i njëjti ka arritur 72.20 pikë nuk është shpallur fitues bazuar në nenin 25 të rregullores së rekrutimit, ngase kjo sipas tij është shkelje e rëndë ngase e ka cenuar të drejtën e tij që të jetë në listën pritëse për qfarëdo pozite të grupit të njëjtë brenda 12 muajve.

Me datën 09.11.2022, Komisioni për vlerësim përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Deçanit, ka nxjerrë Vendimin me numër 40491, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin lidhur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatit fitues, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 09.12.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 7825/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se sipas rezultateve finale lidhur me konkursin në fjalë i shpallur nga Komuna e Deçanit është cekur vetëm kandidati fitues e jo edhe kandidatët tjerë të cilët kanë pasur së paku 70 pikë sipas rregullores përkatëse të rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 14.12.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Deçanit, ndërsa me datën 23.12.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Deçanit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 23.01.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me Nr.Prot:7825/2022 të datës 09.12.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 07.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 14.12.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 23.12.2022 nga Komuna e Deçanit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës; Konkursin me numër RN00009825 të datës 24.08.2022; Vendimin e datës 06.10.2022 për themelimin e komisionit të pranimit së bashku me akt emërimin e datës 01.12.2015, 01.10.2022, 01.10.2012, 01.10.2012 të anëtarëve të komisionit dhe Vendimin e datës 01.07.2022 për pranimin e anëtarit të jashtëm të komisionit të pranimit; Listën e aplikantëve të gjeneruar tek SIMBNJ; Njoftimin e datës 30.09.2022 për listën e ngushtë; Aplikacionin e datës 22.09.2022 të kandidatit së bashku me dëshminë mbi përvojën

profesionale dhe atë të punës si dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e datës 19.09.2022 së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale dhe atë të punës si dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e datës 25.09.2022 të kandidatit së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale, atë të punës si dhe certifikatat e trajnimeve dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e punësimit të datës 16.09.2022 të kandidatit së bashku me dëshminë profesionale dhe atë të punës si dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e datës 26.09.2022 të kandidatit së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale, atë të punës si dhe certifikatat e trajnimeve dhe kopjen e letërnjoftimit; Aplikacionin e datës 20.09.2022 të kandidatit së bashku me dëshminë mbi përvojën profesionale, atë të punës, certifikatat e trajnimeve dhe kopjen e letërnjoftimit; Njoftimin e datës 07.11.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore lidhur me kandidatin e suksesshëm; Vendimin me numër 40491 të datës 09.11.2022 të Komisionit të Pranimit; Ankesën e ankuesit të datës të parashtruar tek Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Deçanit; Njoftimin e datës 07.10.2022 përmes e-mailit zyrtar; Njoftimin e datës 10.10.2022 për mbajtjen e testit me shkrim; Shkresën zyrtare të datës 20.10.2022 e gjeneruar tek simbnj; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 07.11.2022 e gjeneruar tek simbnj si dhe Vendimin VK/2023 të datës 23.01.2023 lidhur me vazhdimin e aftit të ankesës në Këshill.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialisti Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës”, në Komunën e Deçanit, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00009825 për pozitën “Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe monitorim” në Sektorin për Pylltari, për klasën e pozitës Profesional 4, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e shkollës së mesme apo ekuivalente me to.*
- *Kualifikime të posaçme: Nuk ka*
- *Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave, ka konstatuar se për pozitën e lartcekur kanë aplikuar gjashtë (6) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë të gjashtë (6) kandidatët nga lista e aplikimit në mesin e tyre edhe ankuesi. Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit, ankuesi nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 72.20 pikë gjithsejtë dhe se i njëjti është vlerësuar nga Komisioni i pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: “1. Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2. Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit/CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë”.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se me datën 07.11.2022 Komisioni i Pranimit ka shpallur rezultatet mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve për grupin „Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës” pozita “Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim” në Sektorin për Pylltari, për klasën e pozitës Profesional 4, ku

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se me datën 07.11.2022 Komisioni i Pranimi ka shpallur rezultatet mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve për grupin „*Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës*” pozita „*Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim*” në Sektorin për Pylltari, për klasën e pozitës Profesional 4, ku ne baze të vlerësimeve kandidati ka arritë gjithsejtë 81.6 % nga pikët e përgjithshme, nga testi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervista me gojë, dhe është renditur i pari (1) në listën përfundimtare të kandidatëve, ndërsa ankuesi me gjithsejtë 72.2 pikë e përgjithshme dhe është renditur i treti (3) në listën përfundimtare të kandidatëve.

Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Deçanit me datën 07.11.2022, ka publikuar njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare nga procedura e rekrutimit, gjegjësisht ka njoftuar për kandidatin e suksesshëm, me gjithsejtë 81.6 pikë të arritura, andaj ndërlidhur me këtë fakt Kolegji konstaton se publikimi nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Komunës së Deçanit, është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se : **“2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues”**. Nisur nga ky konststim e bazuar në pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se nuk është njoftuar lidhur me pikët e fituara, Kolegji vlereson se organi i punesimit me datën 07.11.2022, ka shpallur listën mbi renditjen përfundimtare të kandidatëve të gjeneruar tek sistemi SIMBNJ, sipas së cilës ankuesi është njoftuar lidhur me pikët e fituara nga kjo procedurë e rekrutimit prej gjithsejtë 72.2 pikë të fituara dhe në këtë kuptim ankuesi edhe pse ka arritur të marrë më shumë se 70 pikë i njëjti është renditur i treti (3) në listën përfundimtare, ngase kandidati fitues në raport me ankuesin ka grumbulluar pikë më shumë se ankuesi, e që bazuar në dispozitën e lartcekur i njëjti nuk ka arritur të mbledhë pikët e mjaftueshme për të përzgjedhur në radhët e kandidatëve fitues për pozitën e lartcekur, andaj edhe pretendimi ankimor i tij në kuptim se i njëjti nuk është përzgjedhur edhe pse ka grumbulluar më shumë se 70 pikë dhe se nuk ka qenë i njofuar lidhur me pikët e fituara është i pa bazuar dhe jo ligjor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga Komuna e Deçanit lidhur me dosjen e kandidatit të përzgjedhur lidhur me pozitën e lartcekur dhe rrjedhimisht ka konstatuar se Komisioni i Pranimi me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për grupin *Specialist i Bujqësisë, Pyjeve dhe Tokës* lidhur me pozitën *“Teknik i Pylltarisë për Mbrojtje dhe Monitorim”* në Sektorin për Pylltari, për klasën e pozitës Profesional 4, si kandidat i cili ka fituar grumbulluar pikë më së shumti në raport me kandidatët e tjerë, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: **“neni 24. Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit”**.

Ndërlidhur me përvojën profesionale të kandidatit të përzgjedhur nga kjo procedurë e rekrutimit, kolegji ka analizuar dëshmitë lidhur me dosjen e kandidatit të përzgjedhur dhe ka konstatuar si në vijim se: i njëjti posedon Diplomën me numër të protokollit 280 të datës 21.06.2010, sipas së cilës dëshmohet se i njëjti me datën 05.06.2010 ka përfunduar shkollën e mesme të lartë në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në drejtimin shkencat natyrore. Kolegji ndërlidhur me dëshmitë tjera lidhur me përvojën profesionale dhe atë të punës, të bashkangjitura nga ana e kandidatit të përzgjedhur, nuk është lëshuar meqenëse të njëjtat nuk janë kërkuar sipas kritereve të konkursit.

klasën e pozitës Profesional 4, si dhe Vendimi me numër 40491 i datës 09.11.2022 i Komisionit të Pranimi në Shërbimin Civil të Komunës së Deçanit, kanë vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1127/2022.

Ardita Perçuku-Shyti



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore Gashi-Bajraktari



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Deçanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Deçanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

